



I shfuqizuar

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

A. Nr. 277/2016
Datë, 16/05/2016
Prishtinë

Kryeprokurori i Shtetit në pajtim me nenin 11 të Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe në pajtim me nenin 1 pika 1.5 të Ligjit Nr. 03/-225 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, me qëllim që të rregullojë mënyrën e dorëzim-pranimit apo marrjes së lëndëve të prokurorëve të suspenduar, të avancuar, të transferuar, prokurorëve në pushim të lehonisë dhe prokurorëve që mungojnë me arsyetim më tepër se gjashtë (6) muaj, më 16/05/2016 nxjerrë këtë:

U D H Ë Z I M

Për dorëzim-pranimin e lëndëve në rast të suspendimit të prokurorëve apo mungesës së prokurorëve nga detyra

- I. Prokurorit të suspenduar me vendim nga Komisioni Disiplinor ose pas ankesës eventuale të konfirmuar me vendim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (këtu e tutje "KPK") duhet t'i lejohet qasja në zyrë me Komision për t'i dorëzuar lëndët, me ç'rast hartohet procesverbali i cili nënshkruhet nga prokurori i suspenduar dhe anëtarët e Komisionit. Komisioni kryesohet nga Kryeprokurori, një prokuror i caktuar nga ana e tij dhe administratori i prokurorisë përkatëse. Në rastet e suspendimit të Kryeprokurorit zbatohet procedura e njëjtë e dorëzimit të lëndëve me përjashtim të përbërjes së komisionit ku kryesues i Komisionit është zëvendës Kryeprokurori i asaj prokurorie.
- II. Në rastin kur prokurori i suspenduar është në pamundësi fizike që të dorëzojë lëndët, ngase ndaj të njëjtit Gjykata ka shqiptuar masen e paraburgimit, apo ndonjë masë tjetër për sigurimin e të pandehurit në procedur penale atëherë Komisioni në përbërje të Kryeprokurorit, një prokurori të caktuar nga ana e tij dhe administratori të prokurorisë përkatëse brenda afatit prej pesë (5) ditësh i merr lëndët nga zyra e prokurorit të suspenduar dhe me këtë rast harton procesverbal ku konstaton numrin dhe natyrën e lëndëve (PP, PPN, PPP). Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit dhe zyrtari përkatës i ngarkuar me lëndët e prokurorit të suspenduar. Në rastin kur suspendohet Kryeprokurori i ndonjë prokurorie, zbatohet procedura e njëjtë e dorëzimit të lëndëve me përjashtim të përbërjes së komisionit ku kryesues i komisionit është zëvendës kryeprokurori i asaj prokurorie.
- III. Njoftimi për suspendimin e prokurorit bëhet nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor të KPK-së apo nga Kryesuesi i KPK-së në rastet kur vendimi i Komisionit Disiplinor është ankimuar në KPK. Një kopje e njoftimit i dërgohet Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse ndërsa në rastet e suspendimit të Kryeprokurorit njoftimi i dërgohet zëvendës Kryeprokurorit të asaj prokurorie.

- IV. Prokurori apo Kryeprokurori i suspenduar lëndët i dorëzon sipas procedurës së paraparë në pikën I duke specifikuar natyrën e lëndëve dhe statusin e tyre. Procesverbal duhet në veçanti të përmbajë shënim për lëndët e natyrës urgjente si në vijim:
- Lëndët në hetime në të cilat ndaj të pandehurit është urdhëruar paraburgimi apo ndonjë masë tjetër për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë;
 - Lëndët në hetime, të cilat prokurori i suspenduar mendon se janë përfunduar hetimet dhe se duhet të ushtr ohet aktakuzë apo pushohet hetimi;
 - Lëndët tjera në hetime;
 - Kallëzimet penale që nuk janë vendosur brenda afatit nga neni 82 paragrafi 1 i KPPK-së ose neni 83 paragrafi 5 i KPPK-së;
 - Lëndët me aktakuza në të cilat është pranuar aktgjykimi dhe është duke rrjedhë afati për ankesë;
 - Lëndët me aktakuza në të cilat është caktuar shqyrtimi gjyqësor apo shqyrtimi është në rrjedhë e sipër, dhe
 - Lëndët tjera nga regjistrat PPN dhe PP që i suspenduari i ka në punë.
- V. Dorëzimi i lëndëve nga prokurori i avancuar, transferuar apo prokurori në pushim të lehonisë bëhet nga vetë prokurori tek Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse dhe me rastin e dorëzimit të lëndëve hartohet procesverbal dhe i njejti nënshkruhet nga prokurori, Kryeprokurori dhe administratori i prokurorisë përkatëse. Dorëzimi i lëndëve bëhet sipas rënditjes të paraparë në pikën IV të këtij Udhëzimi.
- VI. Ndarja e lëndëve të dorëzuara nga prokurorët e suspenduar, të avancuar, të transferuar dhe prokurorëve në pushim të lehonisë bëhet sipas Rregullorës së KPK-së Nr. 06/2015 për Ndarjen e Lëndëve.
- VII. Ky Udhëzim zbatohet nga të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët e prokurorive themelore, Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës
- VIII. Ky Udhëzim hynë në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës.

Prishtinë, më 16/05/2016


Aleksandër Lumezi
Kryeprokuror i Shtetit të Kosovës